



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate



01Nr.1305-08/2026-V

Inspektori i Punës në Inspektoratin Qendror të Punës në regjionin e Prishtinës [REDACTED], i autorizuar sipas nenit 82 dhe 94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, dhe Ligjit Nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, nenit 38 dhe 39 të Ligjit nr.08/I-067 për Inspektimet, konform ankesës së parashtruar në Inspektoratin Qendror të Punës, e protokoluar me datë 20.01.2026, dhe me nr.prot.75, nga [REDACTED] ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor nr.1217, dt.19.12.2025, të Qendrës së Studentëve në Prishtinë, me datë: 26.01.2026, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Inspektorati Qendror i Punës është **JO KOMPETENT** lidhur me ankesën e palës ankuese [REDACTED] ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor nr.1217, dt.19.12.2025, të Qendrës së Studentëve në Prishtinë.
- II. **Përfundohet procedimi administrativ** në shkallë të parë të Inspektoratit Qendror të Punës i filluar sipas ankesës së protokoluar në IQP me datë 20.01.2026, dhe me nr.prot.75, nga [REDACTED] kundër punëdhënësit Qendroë e Studentëve në Prishtinë.

### Arsyetim

Inspektori i Punës ka pranuar ankesën e parashtruar në Inspektoratin Qendrorë të Punës, e protokoluar me datë 20.01.2026, dhe me nr.prot.75, nga [REDACTED] kundër punëdhënësit Qendroë e Studentëve në Prishtinë

Inspektori i Punës bazuar në pretendimet ankimore të palës ankuese, me rastin e trajtimit të lëndës nuk ka gjetur bazë ligjore për të trajtuar ankesën për shkak se Inspektorati Qendror i Punës nuk ka kompetencë të trajtoj pranimin e punonjëseve dhe marrdhëniet e punës të cilat rregullohen me ligje të veçanta, e që në rastin konkret, marrdhënia e punës për të cilën është ankuar ankuesi rregullohet me Ligjin NR.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Për më tepër, në nenin 5, paragrafi 2, të Ligjin NR.08/L-197 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se, "Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve

publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës". Si dhe aktet nënligjore përkatëse sipas nenit 103 të këtij ligji.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë, çështja duhet t'i drejtohet organeve kompetente.

Pra, Inspektorati Qendror i Punës nuk ka kompetencë të trajtoj ankesën e palës ankuese

Prandaj, në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim është përpiluar në kopje të mjaftueshme identike nga një 1 kopje i dorëzohet palëve në procedurë, ndërsa kopjet tjera Inspektorët e Punës i mbajnë për procedurë të mëtejshme.

Inspektori i Punës

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij Vendimi lejohet ankesë në afat prej 30 ditësh, në Komisionin e Ankesave të Inspektoratit Qendror të Punës, nëpërmes Inspektoratit Qendror të Punës në Prishtinë, "Objekti Qendra Tranzite Postare, Zona Industriale, magjistralkja Prishtinë – Fushë Kosovë".